

KALENDARI I PËRBASHKËT KULTUROR

INSPEKTIM

MUZEU I KULTURËS FRANÇESKANE

EDUKIMI PËRMËS KULTURËS

Nënshkruhet Kalendari i përbashkët kulturor vjetor mes Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Kosovës.

Për të gjashtin vit, Shqipëria dhe Kosova kanë një kalendar të përbashkët kulturor. Në ambientet e Ministrisë së Kulturës, Ministri i Kulturës së Shqipërisë, znj. Elva Margariti dhe Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Z. Kujtim Gashi nënshkruan kalendarin, i cili shtrihet përgjatë një viti, jo vetëm në Prishtinë e Tiranë, por edhe qytete të tjera të Shqipërisë e Kosovës. Aktivitetet përfshijnë të gjitha institucionet e kulturës. Nuk do të mungojnë aktivitetet kushtuar librit apo ato për trashëgiminë kulturore.

Restaurimi i Objektit II-227

Inspektim në një nga ndërtesat me vlera të spikatura arkitektonike, e pozicionuar në kryqëzimin e Rugës "Karl Gega" dhe "Reshit Petrela", në Tiranë, ndërtuar në mesin e viteve '30, në stil Neoklasik, por që ishte në kushte tepër të degraduara dhe paraqiste rrezik për kalimtarët dhe humbje totale të vlerave arkitektonike të saj.

Pas diskutimeve me specialistëve të IMK dhe pronarëve të objektit u propozua rivitalizimi i kësaj ndërtese duke i dhënë funksion kafene-restorant.

Falë projektit të restaurimit kjo ndërtesë u rivitalizua dhe u kthye në një ambient atraktiv, duke rritur vlerat e saj dhe të zonës ku ndodhet. Ndërhyrjet përfshinë përforsim të krejt strukturës mbajtëse dhe restaurim të çatisë. Gjithashtu, u kryen ndërhyrje restauruese në fasada si dhe vendosje e dyerve, dritareve, lyerje dhe arredimi i interiorit.

Themelohet muzeu "Lin Delija" në Shkodër ku është prezantuar projekti i Muzeut të Kulturës Françeskane.

Veprat e piktorit të njohur i janë dhuruar këtij Muzeu, që do të shërbejnë për të kujtuar e promovuar veprën e jetën e tij. Historia e pranisë dhe veprimtarisë françeskane në Shqipëri ka një shtrirje 800-vjeçare dhe përbën një nga formatet e rëndësishme sa të besimit katolik ndër shqiptarë aq edhe të historisë politike e shoqërore të vendit.

Muzeu i ardhshëm Françeskan, do të jetë në çdo rast një hapësirë e vogël por e çmuar, për të strehuar këtë trashëgimi të shumanshme që françeskant shqiptarë dhe Kolegji i tyre i mirënjohur krijuan, kultivuan, mblodhën e përpunuan me përkushtim shembullor.

100 nxënës nga shkollat periferike në Tiranë në programet e Edukimit përmës Kulturës

22 nxënës nga shkolla 9-vjeçare "Hasan Tahsin" dhe 82 nxënës të shkollës 9-vjeçare Yrshek morën pjesë në dy programet e Edukimit të organizuar këtë javë nga Muzeu Historik Kombëtar

Programi "Një ditë në muze" ka si qëllim njohjen nga afër të mënyrës së jetesës së popullit tonë ndër shekuj, veglat e punës, traditat, ritet e zakonet.

"Arkeologu i vogël" është një projekt, i cili ka si qëllim të bëjë pjesë të gërmimeve arkeologjike fëmijët nga moshë 7-11 vjeç dhe përdorimi i mjeteve arkeologjike dhe teknikave të gërmimit u jep mundësinë nxënësve të jenë arkeologë për një ditë dhe të bëjnë zbulimet e tyre për epokat kryesore historike në Shqipëri.